

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Kualifikimin Profesional

SHËRBIME KUJDESI PËR FËMIJË

Niveli III i KSHK¹, referuar nivelit III në KEK²

(1 vjeçar)

Kodi: O2-III-25

Miratoi:

MINISTRI

1.Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
2.Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Tiranë, 2025

- I. Qëllimet e kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.**
1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.
- III. Plani mësimor për kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve me zgjedhje të detyruar të praktikës profesionale.**
- XI. Programi orientues për provimet përfundimtare të nivelit.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, Niveli III i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e kujdesit për fëmijë”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin, gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve që ndjekin kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë” niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë ato/ata që:

- kanë përfunduar kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional;
- kanë aftësi të kufizuara, për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitet reale të këtyre shkollave, atëherë, MEKI përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.

Në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikase.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup, si dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë, nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.

Në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin II të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës për kryerjen e shërbimeve të kujdesit për fëmijë.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm, gjatë përkujdesjes për fëmijë.
- Të zbatojë legjislacionin përkatës të shërbimit social dhe shëndetësor për fëmijë.
- Të ruajë konfidencialitetin e të dhënave për punën e kryer.
- Të bashkëpunojë me prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës.
- Të përfshijë prindin/kujdestarin ligjor në kujdesin dhe edukimin e fëmijës.
- Të menaxhojë situata të vështira dhe konflikte, në mënyrë profesionale.
- Të përkujdeset për plotësimin e nevojave bazike të fëmijës.
- Të përkujdeset për shëndetin e fëmijës.
- Të zhvillojë aktivitete edukative, krijuese dhe argëtuese.
- Të përkujdeset për zhvillimin e të folurit dhe komunikimit të fëmijës.
- Të përkujdeset për zhvillimin e orientimit të fëmijës në hapësirë, kohë dhe me ritmin.
- Të përkujdeset për motorikën fine dhe globale të fëmijës.
- Të përkujdeset për zhvillimin e sjelljes shoqërore dhe të autonomisë së fëmijës.
- Të zbatojë standardet e profesionit.
- Të zbatojë parimet e garantimit të të drejtave të njeriut.
- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël për shërbimet e kujdesit për fëmijë.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me shërbimet e kujdesit për fëmijë.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë përkujdesjes për fëmijë.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimit të mëtejshëm në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë fushë. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në qendra rezidenciale ose ditore për fëmijë, në shërbimet komunitare të përkujdesjes, në spitale, për t’u vetëpunësuar si kujdestar për fëmijë ose, mbas një përvije pune, për të krijuar një biznes të vogël në fushën e shërbimeve sociale dhe shëndetësore për fëmijë.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin IV në KSHK, të arsimit profesional (njëvjeçar) në kualifikimin profesional përkatës, për të fituar të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.

Plani mësimor për kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-22	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-21-306-25	Pediatria e përgjithshme	3
3	L-20-744-25	Psikologjia e fëmijërisë	2
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-20-2190-25	Planifikimi dhe organizimi i punës në shërbime kujdesi për fëmijë	33
2	M-20-2191-25	Bashkëpunimi me prindin/kujdestarin ligjor për mirëqenien e fëmijës	68
3	M-20-2192-25	Plotësimi i nevojave bazike të fëmijëve	86
4	M-21-2193-25	Përkujdesja për shëndetin e fëmijës	86
5	M-20-2194-25	Zhvillimi i aktiviteteve edukative, krijuese dhe argëtuese	51

6	M-20-878-25	Përkujdesja për zhvillimin e të folurit dhe komunikimit të fëmija	51
7	M-05-2195-25	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit, gjatë përkujdesjes për fëmijë	33
D.		Modulet me zgjedhje të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	3 (102)
1	M-20-2196-25	Përkujdesja për orientimin e fëmijës në hapësirë, kohë dhe me ritmin	51
2	M-20-2197-25	Përkujdesja për motorikën fine dhe globale të fëmijës	51
3	M-20-874-25	Përkujdesja për zhvillimin e sjelljes shoqërore dhe të autonomisë së fëmijës	51
4	M-17-2199-25	Shoqëria e nxënësve	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/31

IV. Udhëzime për planin mësimor.

Në klasën e 12-të, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësimdhënësit e lëndëve teorike profesionale dhe moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore, etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është **motivimi i nxënësve**. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësimdhënësit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është **integrimi i teorisë me praktikën** e profesionit.

Parimi i “të nxënësve duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të nxënësve në shkollat profesionale të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK. Mësimdhënësit duhet të përdorin metoda të tilla të të nxënësve që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup dhe Metoda e simulimit* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale të kujdestarit për fëmijë në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësimdhënësit dhe është fakti që *të nxënësve nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësimdhënësit përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar.
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehjeve, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e shërbimeve sociale dhe shëndetësore për fëmijët, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III të KSHK.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli, si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MEKI, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-22). Kl. 12 – 68 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror;
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve;
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse;
- të vlerësojnë kërkesat, dëshirat, mundësitë dhe vështirësitë të tyre për karrierën e ardhshme;
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to;
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme;
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore;
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup;
- të analizojnë veçoritë e gatishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore;
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore;
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, paratë, kohën, etj;
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme;
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit digjital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes;
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale;
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre;
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot, etj;
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve;
- të përshkruajnë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje;
- të përshkruajnë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive në mjedisin e punës.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 – 68 orë:

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë (sjellja) sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetëvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	3 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë
Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	3 orë

Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë
Tema 9	Gatishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi digjital dhe mediat sociale	4 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	4 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë
Tema 19	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës	4 orë

2. Lënda “Pediatria e përgjithshme” (L-21-306-25). Kl. 12 – 102 orë

• Synimet e lëndës “Pediatria e përgjithshme”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Pediatria e përgjithshme”, klasa 12, nxënësit duhet:

- të shpjegojnë rëndësinë e zbatimit të politikave të mbrojtjes së fëmijëve;
- të shpjegojnë rëndësinë e shërbimit socio-shëndetësor për fëmijët;
- të shpjegojnë detyrat dhe përgjegjësitë e kujdestarit për fëmijë;
- të shpjegojnë objektin dhe qëllimin e shkencave mjekësore që merren me studimin e fëmijës nga lindja deri në pubertet;
- të përkufizojnë bazat biologjike të trashëgimisë, anomalitë strukturore, si dhe sëmundjet gjenetike;
- të përshkruajnë treguesit demografikë, mortalitetin infantil, rritjen, zhvillimin fizik dhe nevojat ushqimore të fëmijës;
- të përshkruajnë ekzaminimin fizik të të porsalindurit, keqformimet e lindura dhe ikterin e neonatit;
- të identifikojnë nevojat bazike të fëmijës;
- të përlllogaritin medikamentet që përdoren në moshën pediatrike;
- të shpjegojnë çrregullimet/ sëmundjet e sistemit tretës;
- të shpjegojnë sëmundjet e sistemit respirator;
- të shpjegojnë sëmundjet e sistemit kardio-vaskular;
- të shpjegojnë sëmundjet e gjakut dhe organeve hemopoetike;
- të shpjegojnë sëmundjet e gjëndrave endokrine;
- të shpjegojnë sëmundjet e aparatit urinar;
- të shpjegojnë sëmundjet e sistemit nervor;
- të shpjegojnë sëmundjet reumatizmale;
- të shpjegojnë urgjencat mjekësore të moshës pediatrike;
- të shpjegojnë sëmundjet alergjike;
- të shpjegojnë sëmundjet infektive, infeksionet parazitare.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Pediatria e përgjithshme”, kl. 12 - 102 orë:

Tema 1	Rëndësia e zbatimit të politikave të mbrojtjes së fëmijëve	3 orë
---------------	--	-------

Tema 2	Rëndësia e shërbimit socio-shëndetësor për fëmijët	5 orë
Tema 3	Detyrat dhe përgjegjësitë e kujdestarit për fëmijë	6 orë
Tema 4	Bazat biologjike të trashëgimisë	4 orë
Tema 5	Puerikultura. Treguesit demografik.	5 orë
Tema 6	Ekzaminimi fizik të i porsalinduri	5 orë
Tema 7	Nevojat bazike të fëmijës	7 orë
Tema 8	Përlllogaritja e medikamenteve në moshën pediatrike	6 orë
Tema 9	Çrregullimet/ sëmundjet e sistemit tretës	6 orë
Tema 10	Sëmundjet e sistemit respirator	5 orë
Tema 11	Sëmundjet e sistemit kardio-vaskular	5 orë
Tema 12	Sëmundjet e gjakut dhe organeve hemopoetike	6 orë
Tema 13	Sëmundjet e gjëndrave endokrine	6 orë
Tema 14	Sëmundjet e aparatit urinar	6 orë
Tema 15	Sëmundjet e sistemit nervor	6 orë
Tema 16	Sëmundjet reumatizmale	4 orë
Tema 17	Urgjencat mjekësore në moshën pediatrike	5 orë
Tema 18	Sëmundjet alergjike	6 orë
Tema 19	Sëmundjet infektive dhe parazitare	6 orë

2. Lënda “ Psikologjia e fëmijërisë” (L-20-744-25). Kl. 12 – 68 orë

• Synimet e lëndës “Psikologjia e fëmijërisë”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Psikologjia e fëmijërisë”, klasa 12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë zhvillimin e sistemit nervor të fëmijës;
- të shpjegojnë zhvillimin motorik dhe perceptiv të fëmijës;
- të përshkruajnë zhvillimin kognitiv të fëmijës, sipas teorive kryesore (Piaget, Vygotsky);
- të shpjegojnë zhvillimin emocional dhe rëndësinë e atashimit të sigurtë në fëmijëri;
- të shpjegojnë rëndësinë e lojrave formuese në zhvillimin e fëmijës;
- të përshkruajnë aftësitë komunikuese verbale të fëmijës dhe zhvillimin social të tij;
- të përshkruajnë nevojat psikologjike të fëmijës, si dhe rëndësinë e tyre në sigurimin e mirëqenies emocionale;
- të përshkruajnë sjelljet e përshtatshme dhe të papërshtatshme të fëmijës;
- të shpjegojnë rëndësinë e menaxhimit të emocioneve të fëmijës;
- të shpjegojnë rolin që ka familja dhe mjedisi social në zhvillimin e fëmijës;
- të përshkruajnë procesin e të menduarit dhe të përpunimit të informacionit të fëmijët;
- të identifikojnë problemet psiko-sociale të fëmijët;
- të përshkruajnë ndikimin e lojës në zhvillimin e fëmijës;
- të përshkruajnë zhvillimin e aftësisë për zgjidhjen e problemeve dhe të të menduarit kritik të fëmijët;
- të përshkruajnë metodat e menaxhimit të konflikteve, gjatë punës në grup me fëmijët;
- të shpjegojnë rëndësinë e motivimit dhe të mësuarit në arritjet dhe sukseset e fëmijës.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Psikologjia e fëmijërisë” kl.12 - 68 orë:

Tema 1	Zhvillimi i sistemit nervor të fëmijës	5 orë
Tema 2	Zhvillimi motorik dhe perceptiv i fëmijës	5 orë
Tema 3	Zhvillimi kognitiv sipas teorive kryesore	5 orë

Tema 4	Zhvillimi emocional dhe atashimi i sigurtë i fëmijës	5 orë
Tema 5	Zhvillimi social dhe komunikimi	5 orë
Tema 6	Nevojat psikologjike të fëmijës dhe mirëqenia emocionale	5 orë
Tema 7	Sjellja e fëmijës dhe menaxhimi i emocioneve	5 orë
Tema 8	Ndikimi i faktorëve familjarë dhe socialë në zhvillimin e fëmijës	6 orë
Tema 9	Procesi i të menduarit të fëmijës dhe përpunimi i informacionit	5 orë
Tema 10	Problemet psiko-sociale të fëmijët	6 orë
Tema 11	Zgjidhja e problemeve dhe të menduarit kritik të fëmijët	5 orë
Tema 12	Ndikimi i lojës në zhvillimin e fëmijës	5 orë
Tema 13	Motivimi dhe të mësuarit social	6 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

1. Moduli “Planifikimi dhe organizimi i punës në shërbime kujdesi për fëmijë”

Kualifikimi profesional: “Shërbime kujdesi për fëmijë”

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PLANIFIKIMI DHE ORGANIZIMI I PUNËS NË SHËRBIME KUJDESI PËR FËMIJË	M-20-2190-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të planifikuar dhe organizuar punën në shërbimet e kujdesit për fëmijë.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi zbaton detyrat dhe përgjegjësitë e kujdestarit për fëmijë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës; - të përcaktojë detyrat dhe prioritetet e një plani ditor, javor, mujor në përputhje me objektivat; - të shpjegojë rëndësinë e shërbimit socio-shëndetësor për fëmijë; - të shpjegojë politikat e mbrojtjes së fëmijëve; - të zbatojë legjislacionin në fuqi për shërbimin e kujdesit për fëmijë; - të zbatojë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, sipas legjislacionit në fuqi; - të ofrojë shërbim social-shëndetësor për fëmijët, sipas standardeve; - të zbatojë detyrat e kujdestarit për fëmijë; - të zbatojë përgjegjësitë e kujdestarit për fëmijë; - të komunikojë me etikë profesionale; - të zbatojë masat për mbrojtjen e shëndetit personal, sipas protokolleve shëndetësore; - të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë zbatimit të detyrave të kujdestarit për fëmijë;

- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë zbatimit të detyrave të kujdestarit për fëmijë;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë zbatimit të detyrave të kujdestarit për fëmijë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi planifikon procesin e përkujdesjes për fëmijë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të identifikojë faktorët individualë dhe socialë që ndikojnë në përkujdesjen për fëmijë;
- të planifikojë burimet e nevojshme njerëzore, sipas proceseve të punës;
- të përzgjedhë burimet e nevojshme njerëzore, sipas proceseve të punës;
- të planifikojë mjetet, pajisjet dhe materialet, sipas proceseve të punës;
- të përzgjedhë mjetet, pajisjet dhe materialet, sipas proceseve të punës;
- të kontrollojë funksionalitetin e mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas manualeve të përdorimit;
- të bashkëpunojë me kolegët, prindin/ kujdestarin ligjor dhe të tretë në planifikimin e përkujdesjes për fëmijë;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të kryejë llogaritje të thjeshta financiare;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë planifikimit të procesit të përkujdesjes për fëmijë;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë planifikimit të procesit të përkujdesjes për fëmijë;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë planifikimit të procesit të përkujdesjes për fëmijë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi dokumenton punën e kryer.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të përshkruajë formatet dhe mënyrat e dokumentimit të punës;

- të përdorë formatet standarde, sipas proceseve të punës;
- të dokumentojë punën e kryer, sipas formularit të evidentimit;
- të raportojë për realizimin e detyrave në mënyrë periodike, duke respektuar hierarkinë;
- të ruajë konfidencialitetin e të dhënave të dokumentuara;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të kryejë llogaritje të thjeshta financiare;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe dhe kopshte fëmijësh, shtëpi përkujdesi për fëmijë, qendra ditore rezidenciale për fëmijë, shtëpi banimi, etj.
- Mësimdhënësi dhe personeli socio-shëndetësor duhet të përdorin metodën e simulimit për të realizuar situatat e ndryshme të shërbimit dhe të kujdesit për fëmijë që parashikohen në modulet e praktikës profesionale.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të kryer të gjitha procedurat e planifikimit dhe organizimit të përkujdesjes për fëmijë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe, kopshte, qendra ditore dhe rezidenciale të kujdesit për fëmijë, shtëpi banimi, etj.
 - Pajisjet, mjetet ndihmëse dhe artikujt e nevojshëm për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme, për planifikimin dhe organizimin e punës në shërbimet e kujdesit për fëmijë.
 - Materiale ndihmëse, kartela, regjistra, formularë, udhëzues, CD, rregullore, manualë, fatura financiare, etj.
-

2. Moduli “Bashkëpunimi me prindin/kujdestarin ligjor për mirëqenien e fëmijës”

Kualifikimi profesional: “Shërbime kujdesi për fëmijë”

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	BASHKËPUNIMI ME PRINDIN/KUJDESTARIN LIGJOR PËR MIRËQENIEN E FËMIJËS	M-20-2191-25
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të bashkëpunuar me prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës me qëllim sigurimin e mirëqenies së fëmijës, si dhe të menaxhojë situata të vështira, konflikte në mënyrë profesionale.	
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi komunikon me prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të përcaktojë detyrat dhe prioritetet e një plani ditor, javor, mujor në përputhje me objektivat; - të përdorë gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës; - të flasë qartë dhe me intonacion të përshtatshëm; - të tregojë interes për shqetësimet e prindit/kujdestarit ligjor të fëmijës; - të komunikojë duke përdorur gjuhën e trupit/mimikën, për të treguar respekt ndaj prindit/kujdestarit ligjor të fëmijës; - të përdorë teknika të dëgjimit aktiv; - ta dëgjojë pa e ndërprerë prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës; - të tregojë empati gjatë bisedës me prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës; - të përdorë mjete të ndryshme komunikimi, sipas nevojës; - të komunikojë me etikë profesionale; - të zbatojë masat për mbrojtjen e shëndetit personal, sipas protokolleve shëndetësore; - të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale; - të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë takimeve me prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës.	

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi përfshin prindin/kujdestarin ligjor në kujdesin dhe edukimin e fëmijës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të informojë vazhdimisht prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës mbi ecurinë shëndetësore dhe edukative të fëmijës;
- të dokumentojë takimet me prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës;
- të sugjerojë prindin/kujdestarin ligjor për të mbështetur në shtëpi fëmijën, sipas nevojave të tij;
- të inkurajojë prindin/kujdestarin ligjor të marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta me fëmijët;
- të ftojë prindin/kujdestarin ligjor në aktivitete të ndryshme për fëmijët;
- të sugjerojë teknika të thjeshta për të inkurajuar zhvillimin kognitiv dhe social të fëmijës në ambientin e shtëpisë;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të kryejë llogaritje të thjeshta financiare për shërbimet e konsulencës të ofruara për prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë përfshirjes së prindit/kujdestarit ligjor në kujdesin dhe edukimin e fëmijës;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë përfshirjes së prindit/kujdestarit ligjor në kujdesin dhe edukimin e fëmijës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi menaxhon situata të vështira dhe konflikte, në mënyrë profesionale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të përdorë teknika komunikimi profesionale me prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës;
- të reflektojë me qetësi mbi konfliktin;
- të orientojë situatën drejt zgjidhjes së problemit;
- të menaxhojë emocionet në situata të tensionuara;
- të dëgjojë prindin/ujdestarin ligjor, në mënyrë aktive dhe pa ndërprerje;
- të sugjerojë zgjidhje që adresojnë nevojat e fëmijës dhe shqetësimet e prindit/kujdestarit ligjor;

- të përfshijë prindin/kujdestarin ligjor në gjetjen e një zgjidhje të përbashkët;
- të ruajë qasjen objektive dhe profesionale mbi konfliktin;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë menaxhimit të situatave të vështira dhe konflikteve, në mënyrë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe dhe kopshte fëmijësh, shtëpi përkujdesi për fëmijë, qendra ditore rezidenciale për fëmijë, shtëpi banimi, etj.
- Mësimdhënësi dhe personeli socio-shëndetësor duhet të përdorin metodën e simulimit për të lehtësuar bashkëpunimin me prindërit/kujdestarët ligjor të fëmijëve, si dhe përfshirjen e tyre në aktivitete të përbashkëta.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurisë dhe të mbrojtjes në punë, gjatë demonstrimit praktik.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të bashkëpunuar me prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës me qëllim sigurimin e mirëqenies së fëmijës, si dhe të menaxhojë situata të vështira, konflikte në mënyrë profesionale.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe, kopshte, qendra ditore dhe rezidenciale të kujdesit për fëmijë, shtëpi banimi, etj.
 - Mjete kancelarie, fatura financiare, etj.
 - Pajisjet, mjetet ndihmëse dhe artikujt e nevojshëm për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme, për bashkëpunimin me prindërit/ kujdestarët ligjor të fëmijëve.
 - Manuale të kujdesit për fëmijë, manuale me teknika komunikimi, manuale të zgjidhjes së konflikteve.
-

3. Moduli “Plotësimi i nevojave bazike të fëmijëve”

Kualifikimi profesional: “Shërbime kujdesi për fëmijë”

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	LOTËSIMI I NEVOJAVE BAZIKE TË FËMIJËVE	M-20-2192-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për përkujdesjen në plotësimin e nevojave bazike të fëmijëve, me qëllim rritjen e cilësisë së jetesës dhe mirëqenies së tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	86 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi ndihmon fëmijën, gjatë kujdesit personal. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të përzgjedhë mjetet dhe produktete për pastrimin e fëmijës, sipas protokollit dhe grupmoshës; - të ndihmojë fëmijën të lahet, duke respektuar privatësinë dhe sigurinë e tij; - të ndihmojë fëmijën në tualet, duke respektuar privatësinë dhe sigurinë e tij; - të pastrojë fëmijën, sipas nevojës dhe procedurës; - të ndihmojë fëmijën të kujdeset për shëndetin oral; - të përzgjedhë veshjen e përshtatshme, sipas moshës dhe stinës; - të kujdeset për flokët, thonjtë dhe lëkurën e fëmijëve, me qëllim parandalimin e infeksioneve; - të komunikojë me etikë profesionale; - të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë kujdesit personal të fëmijës; - të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë kujdesit personal të fëmijës; - të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë kujdesit personal të fëmijës. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.	

RN 2 Nxënësi ndihmon në ushqyerjen e fëmijës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë;

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përgatisë ushqimin për fëmijën, duke përdorur teknikat përkatëse, sipas grupmoshës;
- të respektojë oraret e ushqyerjes së fëmijëve, sipas vakteve;
- të ndihmojë fëmijën të ushqehet dhe të pijë ujë;
- të ushqejë fëmijën në rast se fëmija nuk ushqehet dot vetë, sipas procedurës përkatëse;
- të inkurajojë fëmijën të ushqehet vetë kur është e mundur;
- të monitorojë rregullisht fëmijën, gjatë vetëushqyerjes;
- të parandalojë rrezikun e mbytjes së fëmijës, gjatë ngrënies, duke përdorur teknikat e duhura;
- t'i japë fëmijës ndihmën e parë në rast mbytjeje nga ushqimi, sipas manualit të ndihmës së shpejtë;
- të ndihmojë fëmijën të pastrohet, gjatë dhe pas ngrënies;
- të ruajë kampionin ushqimor në kushtet e përshtatshme;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë ushqyerjes së fëmijës;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë ushqyerjes së fëmijës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi organizon kushtet për pushimin e fëmijës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të respektojë oraret e regjimit ditor të pushimit;
- të përshtasë temperaturën e dhomës së pushimit/qëndrimit, sipas stinës;
- të ajrosë ambientin e pushimit dhe qëndrimit, sipas procedurës;
- të sistemojë shtratin përpara pushimit dhe pas pushimit, sipas rregullit;
- të vendosë fëmijën në gjumë, sipas regjimit ditor;
- të monitorojë fëmijën periodikisht, gjatë gjumit;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë pushimit të fëmijës;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë pushimit të fëmijës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve	- Ky modul duhet të trajtohet në klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe dhe kopshte fëmijësh, shtëpi përkujdesi për fëmijë, qendra ditore rezidenciale për fëmijë, shtëpi banimi, etj. - Mësimdhënësi dhe personeli socio-shëndetësor duhet të demonstrojë përkujdesjen në ofrimin e shërbimeve bazë të fëmijët si: higjiena personale, ushqyerja, pushimi dhe gjumi. - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. - Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurisë dhe të mbrojtjes në punë, gjatë demonstrimit praktik. - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të përmbushur nevojat bazike të fëmijëve, me qëllim sigurimin e mirëqenies së fëmijës. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënësve.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet mjedisi, pajisjet dhe materialet si më poshtë: - Klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe, kopshte, qendra ditore dhe rezidenciale të kujdesit për fëmijë, shtëpi banimi, etj. - Pajisjet, mjetet ndihmëse dhe artikujt e nevojshëm për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme, të shërbimit dhe kujdesit ndaj fëmijëve. - Materialet ndihmëse për përkujdesje, artikuj sanitarë, artikuj kuzhine. - Protokolle të ndihmës së parë, udhëzues të shërbimeve socio-shëndetësore për fëmijë. - Udhëzues, rregullore, fatura financiare, etj.

4. Moduli “Përkujdesja për shëndetin e fëmijës”

Kualifikimi profesional: “Shërbime kujdesi për fëmijë”

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA PËR SHËNDETIN E FËMIJËS	M-21-2193-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për përkujdesjen ndaj shëndetit të fëmijës së sëmurë, si dhe për të ndihmuar teknikisht gjatë vizitave mjekësore dhe ekzaminimeve të ndryshme.	
Kohëzgjatja e modulit	86 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi përkujdeset për fëmijën e sëmurë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të përzgjedhë mjetet e duhura për përkujdesjen ndaj fëmijës së sëmurë (termometër i thjeshtë dhe digjital, oksimetër, kompresë të ngrohta dhe të ftohta, formular evidentimi, etj); - të kryejë me kujdes mbikëqyrjen e fëmijës së sëmurë; - të vëzhgojë ngjyrën e lëkurës, gjatë përkujdesjes ndaj fëmijës së sëmurë; - të evidentojë prezencën e shenjave të alarmit (vështirësi në frymëmarrje, temperaturë e lartë, letargji, dehidrim i rëndë, të vjella, diarre të shpeshta, konvulsionet, cefale, etj); - të matë frekuencën respiratore, gjatë një minute; - të matë ritmin e zemrës; - të shënojë në formularin e evidentimit rezultatet e vëzhgimeve, gjatë matjeve të shenjave jetësore; - të informojë mjekun për rezultatet e vëzhgimeve; - të komunikojë me etikë profesionale; - të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë përkujdesjes për fëmijën e sëmurë; - të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë përkujdesjes për fëmijën e sëmurë; - të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë përkujdesjes për fëmijën e sëmurë. Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi ndihmon teknikisht, gjatë vizitës mjekësore dhe ekzaminimeve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të ndihmojë teknikisht për mbajtjen e fëmijës, gjatë vizitës mjekësore;
- të ndihmojë në përgatitjen e materialeve për realizimin e procedurave mjekësore;
- të mbajë fëmijën në pozicionin e duhur për ekzaminim faringeal, sipas udhëzimit të mjekut;
- të mbajë fëmijën në pozicionin e duhur për ekzaminim torakal, sipas udhëzimit të mjekut;
- të masë shenjat vitale, sipas udhëzimit të mjekut;
- të kontrollojë peshën e fëmijës;
- të plotësojë formularin e evidentimit me shërbimet e ofruara nga kujdestari;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë vizitës mjekësore dhe ekzaminimeve;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë vizitës mjekësore dhe ekzaminimeve;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë vizitës mjekësore dhe ekzaminimeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi përkujdeset për fëmijën me çrregullime/ sëmundje të sistemit të tretjes.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të veshë pajisjet mbrojtëse (doreza të trasha mjekësore, syze mbrojtëse, kapuç mjekësor, shapka me vrma për ajrosje), gjatë përkujdesjes për fëmijën me çrregullime të tretjes;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përzgjedhë mjetet, pajisjet, instrumentet dhe materialet e duhura për përkujdesjen, gjatë çrregullimeve të tretjes te fëmijët;
- të përkujdeset për fëmijët me diarre;
- të përkujdeset për fëmijët me dehidrim;
- të vlerësojë shkallën e dehidratimit;

- të marrë masa për rehidratimin e fëmijës, sipas shkallës së dehidrimit;
- të përkujdeset për fëmijët me të vjella;
- të përkujdeset për fëmijët me çrregullime kronike të ushqyerjes;
- të vlerësojë konstipacionin;
- të shënojë në dosje të gjitha të dhënat si sasia, shpeshtësia, veçoritë e jashtëqitjes;
- të përkujdeset për fëmijët me stomatit dhe kandidoz orale;
- të kontrollojë elasticitetin e lëkurës;
- të ndihmojë infermieren në marrjen e analizave si: gjak venoz për elektrolit, azotemi, glicemi, urokulturë dhe koprokulturë;
- të parandalojë dëmtimin e lëkurës;
- të përkujdeset për fëmijët obez;
- të zbatojë dietën ushqimore, sipas udhëzimeve të mjekut dietolog;
- të vlerësojë aktivitetin fizik;
- të parandalojë helmimet nga substanca të ndryshme, duke mbajtur substancat helmuese larg fëmijëve);
- të zbatojë me përpikmëri udhëzimet e mjekut;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë përkujdesjes për fëmijën me çrregullime të tretjes;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë përkujdesjes për fëmijën me çrregullime të tretjes;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë përkujdesjes për fëmijën me çrregullime të tretjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi përkujdeset për fëmijët me çrregullime vitaminoze, hormonale dhe aspirim të trupave të huaj.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përkujdeset për fëmijët me Rakit (mungesën e vitaminës D);
- të përgatitë fëmijën për marrjen e vitaminës D, sipas porosisë së mjekut;
- të informojë familjarët për rëndësinë e marrjes së vitaminave;
- të ekspozojë fëmijën në diell në orët e para të mëngjesit (07-09) dhe pasdite në orët (17-19);
- të përkujdeset për simptomat akute të tepricës së vitaminës D si; të vjellat, dehidrimi, temperatura, krampet

- abdominale, dhimbjet e kockave, konvulsionet dhe komën;
- të informojë prindërit për qëndrimin e fëmijës në pozicion të përshtatshëm trupor për të parandaluar deformimin e kockave;
- të përkujdeset për fëmijët me çrregullime kockore;
- të ndihmojë fëmijët me osteomielit;
- të përkujdeset për fëmijët me artrit reumatoid juvenil;
- të reduktojë inflamacionin dhe preventimin e deformimit të kockave të prekura;
- të përkujdeset për fëmijët me çrregullime të tiroides;
- të vlerësojë shenjat e kreatinizmit;
- të menaxhojë trajtimin medikamentoz, i cili vazhdon 8 muaj deri në 2 vjet;
- të informojë familjarët për rëndësinë e aplikimit të terapisë;
- të përkujdeset për fëmijën me trupa të huaj në hundë;
- të pozicionojë fëmijën duke e mbajtur të fiksuar për të kryer heqjen e trupit të huaj në hundë;
- të përkujdeset për fëmijën me trup të huaj në vesh të pozicionuar, për të kryer procedurën e heqjes së trupit të huaj;
- të japë ndihmën e parë në epistaksis;
- të zbatojë me përpikmëri udhëzimet e mjekut;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë përkujdesjes për fëmijët me çrregullime vitaminoze, hormonale dhe aspirim të trupave të huaj;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë përkujdesjes për fëmijët me çrregullime vitaminoze, hormonale dhe aspirim të trupave të huaj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi përkujdeset për fëmijët me çrregullime të sistemit të frymëmarrjes dhe të aparatit kardio-vaskular.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përkujdeset për fëmijët me laringit;
- të përkujdeset për fëmijët me trakeit;
- të kryejë përkujdesjen për fëmijët me sëmundje të rrugëve respiratore si: bronkit, bronkiolit;
- të përkujdeset për fëmijën me pneumoni;
- të përkujdeset për fëmijët me bronkopneumoni;
- të matë frekuencën respiratore dhe të ruajë funksionin optimal respirator;
- të kryejë rregullisht matjen e temperaturës për të

- parandaluar konvulsionet febrile;
- të kryejë aspirimin e sekrecioneve çdo 4 orë për të parandaluar bllokimet e mundshme;
- të përkujdeset për fëmijët me astmë bronkiale;
- të informojë familjarët për krizën astmatike;
- të mbrojë fëmijën nga faktorët shpërthyes të astmës bronkiale;
- të vlerësojë cilësinë e frymëmarrjes (nëse fëmija ka gulçim, nëse zëri është i çjerrë, zhurmat respiratore, rrahjet e zemrës dhe elasticitetin e lëkurës);
- të përkujdeset për fëmijët e prekur nga ethja reumatizmale;
- të parandalojë sëmundjet si: tonsilit, faringit dhe skarlatinën që çojnë në ethen reumatizmale;
- të pozicionojë fëmijën në pozicion të përshtatshëm për të lehtësuar dhimbjet;
- të informojë familjarët për administrimin e medikamenteve, përlllogaritjen e tyre, si dhe shenjave që tregojnë keqësim të gjendjes së tyre (ushqyerje me vështirësi, irritim, gjendje gjumi, edemë rreth syve dhe ekstremiteteve);
- të matë rregullisht pulsën dhe të raportojë te mjeku për ndryshimet e ritmit të zemrës;
- të ruajë higjienën e lartë të gojës dhe të dhëmbëve;
- të shënojë në kartelë të gjitha procedurat e realizuara;
- të zbatojë me përpikmëri udhëzimet e mjekut;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë përkujdesjeve për fëmijët me çrregullime të sistemit të frymëmarrjes dhe të aparatit kardio-vaskular.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi përkujdeset për fëmijët me çrregullime dhe sëmundje të aparatit hemopoetik dhe të sistemit urinar.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të veshë pajisjet mbrojtëse (doreza të trasha mjekësore, syze mbrojtëse, kapuç mjekësor, shapka me vrime për ajrosje), gjatë përkujdesjes për fëmijën me çrregullime/ sëmundje të sistemit të tretjes;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përkujdeset për fëmijët me anemi;
- të kryejë përkujdesjen në aneminë nga mungesa e Fe;
- të marrë masa për eliminimin e shkaqeve të anemisë;
- të zbatojë dietën ushqimore në një fëmijë anemik;
- të përkujdeset në dhënien e vitaminës B₁₂, acidit folik dhe

ferro-sulfatit;

- të ndërgjegjësojë familjarët për trajtimin e anemisë;
- të përkujdeset për fëmijët në hemofili;
- të vlerësojë hemoragjinë tek fëmijët me hemofili;
- të përkujdeset për fëmijët me leucemi;
- të përkujdeset për fëmijën me infeksione të rrugëve urinare;
- të përkujdeset për fëmijën me enurezis nikturë;
- të orientojë familjarët për trajtimin e enurezis nikturë;
- të përkujdeset për fëmijën në sindromin nefrotik;
- të shënojë të gjithë të dhënat në dosjen e fëmijës;
- të përkujdeset për fëmijët me insuficiencë renale akute;
- të monitorojë diurezën;
- të përkujdeset për fëmijët me glomerulonefrit akut (post streptokoksik);
- të monitorojë shenjat vitale dhe bilancin elektrolit-lëngje për të vlerësuar funksionin renal;
- të shënojë në kartelë të gjitha procedurat e realizuara;
- të zbatojë me përpikmëri udhëzimet e mjekut;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë përkujdesjes për fëmijët me çrregullime dhe sëmundje të aparatit hemopoetik dhe të sistemit urinar;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë përkujdesjes për fëmijët me çrregullime dhe sëmundje të aparatit hemopoetik dhe të sistemit urinar;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë përkujdesjes për fëmijët me çrregullime dhe sëmundje të aparatit hemopoetik dhe të sistemit urinar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Udhëzime për
zbatimin e modulit
dhe për vlerësimin
e nxënësve**

- Ky modul duhet të trajtohet në spitale pediatrike, qendra shëndetësore, konsultore fëmijësh, shtëpi banimi për të realizuar kujdesin, mbikëqyrjen e fëmijës së sëmurë dhe administrimin e barnave.
- Mësimdhënësi dhe personeli socio-shëndetësor duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të përkujdesjes, mbikëqyrjes së fëmijës së sëmurë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurisë dhe të mbrojtjes në punë, gjatë demonstrimit praktik.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të realizuar

	kujdesin, mbikëqyrjen e fëmijës së sëmurë, përkujdesjen ndaj fëmijëve me çrregullime të tretjes, vitaminoze, hormonale, të sistemit të frymëmarrjes, të aparatit kardio-vaskular, të aparatit hemopoetik, të sistemit urinar nga pickime të ndryshme, aspirim të trupave të huaj. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizmit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet mjedisi, pajisjet dhe materialet si më poshtë: - Klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe, kopshte, qendra ditore dhe rezidenciale të kujdesit për fëmijë, shtëpi banimi, spitale pediatrike, konsultore fëmijësh, etj. - Formularë të përgatitur përkatësisht për kujdesin, mbikëqyrjen e fëmijës së sëmurë dhe administrimin e barnave. - Shtrat mjekësor. Doreza. - Tabaka për dhënien e medikamenteve. - Kosh për hedhjen e mbeturinave. - Materiale të tjera për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme të shërbimit dhe kujdesit ndaj fëmijëve. - Materialet ndihmëse për përkujdesje dhe artikuj sanitarë. - Udhëzuesa, katalogë, rregullore, etj.

5. Moduli “Zhvillimi i aktiviteteve edukative, krijuese dhe argëtuese”

Kualifikimi profesional: “Shërbime kujdesi për fëmijë”

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE EDUKATIVE, KRIJUESE DHE ARGËTUESE	M-20-2194-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të realizuar aktivitete krijuese, argëtuese dhe edukative, të cilat mbështesin zhvillimin e plotë të fëmijës dhe sigurimin e mirëqenies së tij sociale.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi zhvillon aktivitete edukative. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të ushtrojë fëmijën për zhvillimin e aftësive njohëse nëpërmjet shqisës së të parit; - të përgatisë aktivitete edukative që përfshijnë lojëra, ushtrime që zhvillojnë aftësitë kognitive dhe sociale të fëmijëve; - të përdorë mjete dhe materiale të përshtatshme për aktivitetet edukative; - të përdorë lojëra dhe metoda interaktive për të rritur angazhimin e fëmijëve; - të përshtasë aktivitetet në përputhje me nevojat dhe dëshirat e fëmijëve; - të inkurajojë fëmijët, gjatë aktiviteteve edukative; - të përshtasë ambientin në mënyrë të sigurt për fëmijët; - të komunikojë me etikë profesionale; - të zbatojë masat për mbrojtjen e shëndetit personal, sipas protokolleve shëndetësore; - të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë zhvillimit të aktiviteteve edukative; - të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale; - të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë zhvillimit të aktiviteteve edukative;	

- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë zhvillimit të aktiviteteve edukative.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi ushtron fëmijën të zhvillojë kreativitetin.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të ushtrojë fëmijën për zhvillimin e kreativitetit;
- të përdorë materiale të ndryshme që stimulojnë kreativitetin e fëmijës (ngjyra, letra);
- të krijojë aktivitete që nxisin imagjinatën e fëmijëve (vizatim, punë me plastelinë);
- të inkurajojë te fëmijët ide të reja dhe shprehjen e lirë të mendimit;
- të krijojë një ambient të ngrohtë, të sigurtë, që motivon fëmijët për kreativitetin e tyre;
- të vlerësojë fëmijën për çdo përpjekje dhe punim që realizon;
- të inkurajojë punën individuale të fëmijës;
- të inkurajojë fëmijët të ndërveprojnë me njëri tjetrin;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë ushtrimit të fëmijës për zhvillimin e kreativitetit;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë ushtrimit të fëmijës për zhvillimin e kreativitetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi organizon aktivitete argëtuese për fëmijën.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përzgjedhë mjedisin e përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve argëtuese për fëmijën;
- të përzgjedhë materialet dhe lodrat e duhura për fëmijën, sipas interesit dhe aftësive të tij;
- të kombinojë aspektet argëtuese me ato edukative;
- të organizojë aktivitete në grup, që të nxisë socializimin dhe bashkëpunimin;
- të zbatojë aktivitete që përfshijnë lëvizje, si lojëra në natyrë, etj;
- të krijojë aktivitete të ndryshme argëtuese që përfshijnë muzikë, lojë me topa, sportive, etj;

- të komunikojë me etikë profesionale;
- të kryejë llogaritje të thjeshta financiare;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë organizimit të aktiviteteve argëtuese për fëmijën;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë organizimit të aktiviteteve argëtuese për fëmijën.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe dhe kopshte fëmijësh, shtëpi përkujdesi për fëmijë, qendra ditore rezidenciale për fëmijë, shtëpi banimi, etj.
- Mësimdhënësi dhe personeli socio-shëndetësor duhet të demonstrojë me korrektësi veprimtaritë praktike për zhvillimin e aktiviteteve edukative, krijuese dhe argësuese tek fëmijët.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurisë dhe të mbrojtjes në punë, gjatë demonstrimit praktik.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të realizuar aktivitete krijuese, argëtuese dhe edukative, të cilat mbështesin zhvillimin e plotë të fëmijës dhe sigurimin e mirëqenies së tij sociale.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe, kopshte, qendra ditore dhe rezidenciale të kujdesit për fëmijë, shtëpi banimi, etj.
 - Pajisjet, mjetet ndihmëse dhe artikujt e nevojshëm për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme.
 - Udhëzues, CD, protokolle, rregullore, manuale për rëndësinë e lojës në zhvillimin e fëmijës, fatura financiare, etj.
-

6. Moduli “Përkujdesja për zhvillimin e të folurit dhe komunikimit te fëmija”

Kualifikimi profesional: “Shërbime kujdesi për fëmijë”

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA PËR ZHVILLIMIN E TË FOLURIT DHE KOMUNIKIMIT TE FËMIJA	M-20-878-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë praktike për zhvillimin e të folurit të kuptueshëm, të komunikimit verbal dhe joverbal te fëmija.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi ushtron fëmijën në zhvillimin e të folurit të kuptueshëm. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të përzgjedhë mjetet/sendet/materialet e duhura për zhvillimin e të folurit të kuptueshëm te fëmija; - të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija; - të ushtrojë fëmijën të reagojë ndaj emrit të vet; - të ushtrojë fëmijën të japë ose tregojë objekte, sipas kërkesës; - të ushtrojë fëmijën të zbatojë udhëzime të thjeshta; - të ushtrojë fëmijën të formojë fjali të thjeshta; - të ushtrojë fëmijën të riprodhojë histori të thjeshta; - të ushtrojë fëmijën të formojë fjali negative; - të ushtrojë fëmijën të përdorë përemrat; - të ushtrojë fëmijën të formojë fjali pyetëse; - të ushtrojë fëmijën të përdorë mënyrën kushtore të foljes; - të komunikojë me etikë profesionale; - të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale; - të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë ushtrimit të fëmijës për zhvillimin e aftësisë së të folurit të kuptueshëm. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.	

RN 2 Nxënësi ushtron fëmijën në zhvillimin e komunikimit verbal.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përzgjedhë mjetet/sendet/materialet e duhura për zhvillimin e komunikimit verbal të fëmija;
- të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija;
- të ndihmojë fëmijën në emetimin e tingujve;
- të ndihmojë fëmijën në përgjigjen me zë kur është i stimuluar;
- të ushtrojë fëmijën për rishqiptimin e rrokjeve;
- të ushtrojë fëmijën për rishqiptimin e fjalëve të identifikueshme;
- të ushtrojë fëmijën në përdorimin e "po" dhe "jo";
- të ushtrojë fëmijën në përdorimin e zhargonit;
- të ushtrojë fëmijën në emërtimin e disa objekteve të njohura;
- të ushtrojë fëmijën të shprehet me fjalë dhe fjali;
- të ndihmojë fëmijën në formulimin e pyetjeve;
- të ushtrojë fëmijën të shprehet me fjali të shkurtra;
- të ushtrojë fëmijën për tregimin e ngjarjeve;
- të ushtrojë fëmijën për përdorimin në mënyrë korrekte të përemrave;
- të ushtrojë fëmijën për përdorimin në mënyrë korrekte të kohëve të foljeve;
- të ushtrojë fëmijën për përdorimin e mbiemrave;
- të ushtrojë fëmijën për përdorimin e parafjalëve;
- të ushtrojë fëmijën për përdorimin e fjalive të varura;
- të ushtrojë fëmijën për të shprehur në mënyrë të qartë;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi ushtron fëmijën në zhvillimin e komunikimit joverbal.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përzgjedhë mjetet/sendet/materialet e duhura për zhvillimin e komunikimit joverbal të fëmija;
- të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija;
- të vlerësojë reagimin e fëmijës ndaj të prekurit dhe gudulisjes;
- të vlerësojë kuptimin e situatave nga fëmija, bazuar në lidhjen e objekteve me veprimin (pjatë – të ngrënit);
- të vlerësojë bërtitjen e fëmijës kur kërkon diçka/dikë;
- të vlerësojë reagimin e fëmijës në mënyrë të përshtatshme ndaj mimikave;

- të ushtrojë fëmijën në shikimin e një objekti/një personi që i tregohet;
- të ushtrojë fëmijën në kuptimin e gjesteve të thjeshta;
- të ushtrojë fëmijën në përdorimin e mimikës për të shprehur emocionet e tij;
- të ndihmojë fëmijën të shprehë “po/jo” me kokë ose me gjeste;
- të ushtrojë fëmijën në tregimin me gisht;
- të ushtrojë fëmijën të përshëndesë me dorë;
- të ushtrojë fëmijën të shprehet me gjeste;
- të ushtrojë fëmijën të shprehet me ndihmën e figurave;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë ushtrimit të fëmijës në zhvillimin e komunikimit joverbal.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe dhe kopshte fëmijësh, shtëpi përkujdesi për fëmijë, qendra ditore rezidenciale për fëmijë, shtëpi banimi, etj.
- Mësimdhënësi dhe personeli socio-shëndetësor duhet të demonstrojë me korrektësi veprimtaritë praktike dhe procedurat e ushtrimit të folurit dhe komunikimit të fëmijës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurisë dhe të mbrojtjes në punë, gjatë demonstrimit praktik.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, që përdoren për zhvillimin e folurit të kuptueshëm, komunikimit verbal dhe joverbal të fëmijës.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, personat në nevojë social-shëndetësore, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe, kopshte, qendra ditore dhe rezidenciale të kujdesit për fëmijë, shtëpi banimi, etj.
 - Pajisjet dhe artikujt sanitarë të nevojshëm për përkujdesje dhe artikuj sanitarë.
 - Pajisje për të realizuar zhvillimin e folurit të kuptueshëm të fëmijës, simulimin e situatave të ndryshme të shërbimit
-

-
- dhe kujdesit ndaj fëmijëve.
- Udhëzuesa, CD, rregullore, etj.
-

7. Moduli “Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit, gjatë përkujdesjes për fëmijë”

Kualifikimi profesional: “Shërbime kujdesi për fëmijë”

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	SIGURIA NË PUNË DHE MBROJTJA E MJEDISIT, GJATË PËRKUJDESJES PËR FËMIJË	M-05-2195-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të zbatuar standardet e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi zbaton rregullat e sigurisë në punë, gjatë përkujdesjes për fëmijë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të përshkruajë standardet dhe legjislacionin shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik; - të shpjegojë domosdoshmërinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës; - të monitorojë vlefshmërinë e dokumentacionit teknik; - të monitorojë gatishmërinë e pajisjeve të MZSH-së; - të monitorojë vendosjen e sinjalistikës përkatëse dhe materialeve informuese; - të zbatojë masat për sigurinë në punë; - të zbatojë rregullat për parandalimin e aksidenteve; - të zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë; - të zbatojë procedurat për evakuim në rast emergjencash; - të zbatojë protokollet e duhura në rast gjendjesh të jashtëzakonshme; - të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale; - të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë zbatimit të rregullave të sigurisë në punë; - të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë zbatimit të rregullave të sigurisë në punë. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.	

RN 2 Nxënësi zbaton rregullat për mbrojtjen e mjedisit, gjatë përkujdesjes për fëmijët.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përshkruajë rëndësinë e zhvillimit të mjedisit të qëndrueshëm;
- të shpjegojë faktorët ndikues në ndotjen e ambientit;
- të zbatojë procedurat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
- të zbatojë rregullat për mbrojtjen e mjedisit dhe standardet ekologjike;
- të zbatojë rregullat e përdorimit efikas të burimeve;
- të zbatojë procedurat për ndarjen e mbetjeve, sipas llojit;
- të zbatojë procedurat e ruajtjes dhe grumbullimit të mbetjeve;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë zbatimit të rregullave për mbrojtjen e mjedisit;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë zbatimit të rregullave për mbrojtjen e mjedisit;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë zbatimit të rregullave për mbrojtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe dhe kopshte fëmijësh, shtëpi përkujdesi për fëmijë, qendra ditore rezidenciale për fëmijë, shtëpi banimi, etj.
- Mësimdhënësi dhe personeli socio-shëndetësor duhet të demonstrojë me korrektësi veprimtaritë praktike për zbatimin e standardeve të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë përkujdesjes për fëmijë.
- Mësimdhënësi dhe personeli socio-shëndetësor duhet të përdorin metodën e simulimit, lojës në role për të realizuar situatat e ndryshme që parashikohen në këtë modul.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete, në zbatimin e standardeve të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë përkujdesjes për fëmijë.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurisë dhe të mbrojtjes në punë, gjatë përkujdesjes për fëmijë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të zbatuar standardet e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë përkujdesjes për fëmijë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizmit të specifikuar për çdo rezultat të nxënësit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet mjedisi, pajisjet dhe materialet si më poshtë:

- Klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe, kopshte, qendra ditore dhe rezidenciale të kujdesit për fëmijë, shtëpi banimi, etj.
 - Mjete të tjera për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.
 - Materialet ndihmëse për përkujdesje, artikuj sanitarë, artikuj kuzhine.
 - Protokolle të ndihmës së parë, udhëzues të shërbimeve socio-shëndetësore për fëmijë.
 - Udhëzuesa, rregullore, fatura financiare, etj.
-

X. Përshkruesit e moduleve me zgjedhje të detyruar të praktikës profesionale

1. Moduli “Përkujdesja për orientimin e fëmijës në hapësirë, kohë dhe me ritmin”

Kualifikimi profesional: “Shërbime kujdesi për fëmijë”

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kod	PËRKUJDESJA NDAJ FËMIJËS PËR ORIENTIMIN E FËMIJËS NË HAPËSIRË, KOHË DHE ME RITMIN	M-20-2196-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të ushtruar fëmijën të orientohe në hapësirë, në kohë dhe me ritmin.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi ushtron fëmijën për orientimin në hapësirë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të përzgjedhë mjetet e duhura për ushtrimin e fëmijës për orientimin në hapësirë; - të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija; - të ushtrojë fëmijën për imitimin e lëvizjeve të të rriturve; - të ushtrojë fëmijën për zhvendosjen në dhomë, sipas udhëzimeve që i jepen me gojë; - të përkujdeset për realizimin nga fëmija të një udhëzuesi me terma kryesore që lidhen me hapësirën (mbi, nën, etj); - të përkujdeset për ndjekjen e një itinerari të thjeshtë, në mënyrë grafike, nga fëmija (bashkon pikat, etj); - të ushtrojë fëmijën për pozicionimin në mënyrë korrekte të objekteve mbi një sipërfaqe (puna në pasqyrë); - të ushtrojë fëmijën për pozicionimin në mënyrë korrekte të objekteve mbi një sipërfaqe (puna me model); - të përkujdeset për përdorimin nga fëmija i fjalëve që lidhen me sipërfaqen si mbi, nën, etj; - të komunikojë me etikë profesionale; - të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë ushtrimit të fëmijës për t’u orientuar në hapësirë;	

- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë ushtrimit të fëmijës për t'u orientuar në hapësirë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi ushtron fëmijën për orientimin në kohë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përzgjedhë mjetet e duhura për ushtrimin e fëmijës për orientimin kohor;
- të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija;
- të ushtrojë fëmijën për orientimin në kohë (para/tani/pastaj);
- të ushtrojë fëmijën për orientimin gjatë ditës (mëngjes, mesditë, pasdite, mbrëmje, etj);
- të ushtrojë fëmijën për orientimin me ditët e javës;
- të ushtrojë fëmijën për vendosjen e një ngjarje në lidhje me dje/sot/nesër;
- të ushtrojë fëmijën për vendosjen e një ngjarje në lidhje me muajt;
- të ushtrojë fëmijën për orientimin, sipas stinëve;
- të ushtrojë fëmijën të njohë orën;
- të mbajë shënimet e duhura lidhur me ushtrimin e fëmijës për orientimin kohor;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë ushtrimit të fëmijës për t'u orientuar në kohë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi ushtron fëmijën për orientimin me ritmin.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përzgjedhë mjetet e duhura për përkujdesjen për ushtrimin e fëmijës për orientimin me ritmin;
- të sigurojë mjedisin ku do të ushtrohet fëmija;
- të ushtrojë fëmijën të godasë, sipas ritmit të tij;
- të ushtrojë fëmijën të godasë, sipas një ritmi të dhënë;
- të ushtrojë fëmijën të riprodhojë një strukturë ritmike të thjeshtë me ndihmën e një materiali, duke alternuar dy

elemente;

- të ushtrojë fëmijën të riprodhojë një strukturë ritmike komplekse me ndihmën e një materiali, duke alternuar tri elemente;
- të ushtrojë fëmijën të riprodhojë në mënyrë grafike një strukturë ritmike;
- të ushtrojë fëmijën të prodhojë një kadencë (strukturë ritmike e krijuar nga fëmija);
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe dhe kopshte fëmijësh, shtëpi përkujdesi për fëmijë, qendra ditore rezidenciale për fëmijë, shtëpi banimi, etj.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete, si dhe procedurat për ushtrimin e fëmijëve për orientimin në hapësirë, në kohë dhe me ritmin.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurisë dhe të mbrojtjes në punë, gjatë demonstrimit praktik.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të ushtruar fëmijën të orientohet në hapësirë, në kohë dhe me ritmin.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe, kopshte, qendra ditore dhe rezidenciale të kujdesit për fëmijë, shtëpi banimi, etj.
 - Pajisjet, mjetet ndihmëse dhe artikujt të nevojshëm për orientimin e fëmijës në hapësirë, në kohë dhe me ritmin.
 - Udhëzues, CD, rregullore, manualë, fatura financiare, etj.
-

2. Moduli “Përkujdesja për motorikën fine dhe globale të fëmijës”

Kualifikimi profesional: “Shërbime kujdesi për fëmijë”

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA PËR MOTORIKËN FINE DHE GLOBALE TË FËMIJËS	M-20-2197-25
Qëllimi i modulit	Ky modul i pajis nxënësit me aftësi praktike për të mbështetur zhvillimin e motorikës fine dhe globale të fëmijët, në përputhje me moshën dhe nevojat individuale të tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi vlerëson zhvillimin motorik të fëmijës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të sigurojë vendin ku do të ushtrohet fëmija; - të vëzhgojë lëvizjet fizike të fëmijës në situta të ndryshme ndërveprimi; - të identifikojë ndryshimet midis zhvillimit tipik dhe atij me vonesa në motorikën fine dhe globale të fëmijës; - të aplikojë listë kontrolli ose instrumente vlerësimi për zhvillimin motorik, sipas grupmoshave; - të bashkëpunojë me ekipin multidisiplinar për vlerësimin e plotë të fëmijës; - të komunikojë me etikë profesionale; - të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale; - të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë vlerësimit të zhvillimit motorik të fëmijës; - të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë vlerësimit të zhvillimit motorik të fëmijës. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi ushtron fëmijën të zhvillojë motorikën fine. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës;

- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e duhura për kujdesin ndaj fëmijës, gjatë ushtrimit të motorikës fine;
- të sigurojë një mjedis të përshtatshëm dhe mbështetës me stimuj motorikë për fëmijën;
- të ushtrojë fëmijën në ushtrime për forcimin e duarve dhe gishtave;
- të ushtrojë fëmijën me anë të plastelinës, baltës;
- të ushtrojë fëmijën për të mbajtur një objekt të vogël;
- të ushtrojë fëmijën në koordinimin e veprimeve përmes syve dhe duarve;
- të ushtrojë fëmijën me lojërat me puzzle, duke i vendosur në vendin e duhur;
- të ushtrojë fëmijën të ngjyrosë brenda vijave;
- të ushtrojë fëmijën që të përdorë gërshërën;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë ushtrimit të motorikës fine te fëmijët;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë ushtrimit të motorikës fine te fëmijët;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë ushtrimit të motorikës fine te fëmijët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi ushtron fëmijën të zhvillojë motorikën globale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e duhura për kujdesin ndaj fëmijës, gjatë ushtrimit të motorikës globale;
- të sigurojë një mjedis të sigurt për zhvillimin e lëvizjeve motorike globale;
- të përdorë mjete dhe lodra stimuluese që ndihmojnë në zhvillimin e motorikës globale;
- të vlerësojë progresin e fëmijës dhe të përshtatë aktivitetet, sipas nevojës;
- të inkurajojë fëmijën, gjatë aktiviteteve;
- të ushtrojë fëmijën të ulët, në pozicione të ndryshme;
- të ushtrojë fëmijën të ecë;
- të ushtrojë fëmijën të vrapojë;
- të ushtrojë fëmijën për hedhjen dhe pritjen e topit;

- të ushtrojë fëmijën të lëvizë me anë të ritmit të muzikës;
- të motivojë fëmijën të përfshihet në aktivitete sportive;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë ushtrimit të motorikës globale të fëmijët;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë ushtrimit të motorikës globale të fëmijët;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë ushtrimit të motorikës globale të fëmijët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe dhe kopshte fëmijësh, shtëpi përkujdesi për fëmijë, qendra ditore rezidenciale për fëmijë, shtëpi banimi, etj.
- Mësimdhënësi dhe personeli socio-shëndetësor duhet të demonstrojë me korrektësi veprimtaritë praktike për zhvillimin e motorikës fine dhe globale të fëmijës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurisë dhe të mbrojtjes në punë, gjatë demonstrimit praktik.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për të mbështetur zhvillimin e motorikës fine dhe globale të fëmijët, në përputhje me moshën dhe nevojat individuale të tyre.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizmit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, personat në nevojë social-shëndetësore, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe, kopshte, qendra ditore dhe rezidenciale të kujdesit për fëmijë, shtëpi banimi, etj.
 - Pajisje dhe materiale didaktike të nevojshme për të ushtruar të fëmija zhvillimin e motorikës fine dhe globale.
 - Udhëzuesa, CD, rregullore, manuale të zhvillimit të motorikës fine dhe globale, etj.
-

3. Moduli “Përkujdesja për zhvillimin e sjelljes shoqërore dhe të autonomisë së fëmijës”

Kualifikimi profesional: “Shërbime kujdesi për fëmijë”

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA PËR ZHVILLIMIN E SJELLJES SHOQËRORE DHE TË AUTONOMISË SË FËMIJËS	M-20-874-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi profesionale për të mbështetur zhvillimin e pavarësisë dhe integritimit social të fëmijëve, si dhe të ndihmojnë fëmijët në zhvillimin e aftësive të vetëkujdesit, ndërveprimit social dhe pjesëmarrjes aktive në jetën e përditshme.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi zbaton teknika për të nxitur vetëkujdesin te fëmija. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën në vendin e punës; - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës; - të identifikojë saktë nevojat e fëmijës për vetëkujdes, sipas moshës dhe zhvillimit; - të demonstrojë teknika për të mësuar fëmijën të kujdeset për higjienën personale (larje e duarve, trupit, dhëmbët, etj); - të ushtrojë fëmijën për përdorimin e tualetit dhe ndjekjen e rregullave të higjienës; - të ushtrojë fëmijët për t’u kujdesur për shëndetin oral. - të ndihmojë fëmijën të mbajë pastër rrobat dhe sendet personale; - të ushtrojë fëmijën të kujdeset për sendet e tij personale (p.sh. të palosin rrobat); - të ushtrojë fëmijën të veshë dhe zhveshë rrobat në mënyrë të pavarur; - të ushtrojë fëmijën të lidhë këpucët; - të ushtrojë fëmijën të mbajë lugën, pirunin, gotën, në mënyrë të pavarur; - të ushtrojë fëmijën të hajë vetë, sipas moshës dhe aftësive të tij; - të komunikojë me etikë profesionale me fëmijën; - të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë zbatimit të teknikave për të nxitur	

- vetëkujdesin te fëmija;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë zbatimit të teknikave për të nxitur vetëkujdesin te fëmija;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë zbatimit të teknikave për të nxitur vetëkujdesin te fëmija.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi mbështet fëmijën, sipas nevojave individuale të tij.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës;
- të vlerësojë nevojat individuale të fëmijës;
- të identifikojë vështirësitë dhe aftësitë e fëmijës në përkujdesjen për veten dhe ndërveprimin me të tjerët;
- të ofrojë mbështetje të personalizuar, bazuar në nevojat dhe aftësitë e fëmijës;
- të përdorë teknika që nxisin pavarësinë dhe vetëbesimin e fëmijës;
- të inkurajojë ndërveprimin dhe komunikimin e fëmijës me të tjerët;
- të zhvillojë aktivitete që nxisin integrimin dhe përfshirjen sociale të fëmijës;
- të përdorë gjuhë të përshtatshme, sipas nevojave të fëmijës;
- të bashkëpunojë me familjen/profesionistët për të siguruar mbështetje të vazhdueshme;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë mbështetjes së fëmijës, sipas nevojave individuale të tij;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë mbështetjes së fëmijës, sipas nevojave individuale të tij;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes në punë, gjatë mbështetjes së fëmijës, sipas nevojave individuale të tij.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi përdor metoda edukative për të forcuar autonominë e fëmijës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të vëzhgojë nëse fëmija është i aftë të kryejë veprime të thjeshta të vetëkujdesit;
- të identifikojë aktivitetet që fëmija i kryen në mënyrë të pavarur dhe ato që kërkojnë mbështetje;
- të aplikojë metodën e modelimit, duke demonstruar hapat e një veprimi;

- të inkurajojë fëmijën të përsërisë një veprim, duke përforcuar sjelljen;
- të motivojë fëmijën për përpjekjet e tij;
- të përfshijë fëmijën në detyra të caktuara çdo ditë;
- të zhvillojë lojëra që ndihmojnë fëmijën të zhvillojë aftësitë e vetëkujdesit;
- të ushtrojë fëmijën të presë radhën;
- të ushtrojë fëmijën të ndajë lodrat me të tjerët, përmes lojës me role;
- të vëzhgojë sjelljen e fëmijës, në mjedisin ku ndërvepron;
- të përfshijë prindërit/familjen në punën me fëmijët;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë përdorimit të metodave edukative për të forcuar autonominë e fëmijës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe dhe kopshte fëmijësh, shtëpi përkujdesi për fëmijë, qendra ditore rezidenciale për fëmijë, shtëpi banimi, etj.
- Mësimdhënësi dhe personeli socio-shëndetësor duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete, për përkujdesjen për ushtrimin e fëmijës në plotësimin e nevojave personale.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurisë dhe të mbrojtjes në punë, gjatë demonstrimit praktik.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për të mbështetur zhvillimin e pavarësisë dhe integritetit social të fëmijëve, si dhe të ndihmojnë fëmijët në zhvillimin e aftësive të vetëkujdesit, ndërveprimit social dhe pjesëmarrjes aktive në jetën e përditshme.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, personat në nevojë social-shëndetësore, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë, kabinet kujdesi social-shëndetësor, çerdhe, kopshte, qendra ditore dhe rezidenciale të kujdesit për fëmijë, shtëpi

banimi, etj.

- Pajisje dhe artikuj sanitarë të nevojshëm për përkujdesje.
 - Pajisje për të realizuar ushqyerjen e fëmijës, simulimin e situatave të ndryshme të shërbimit dhe kujdesit ndaj fëmijëve.
 - Udhëzues të autonomisë personale dhe autonomisë sociale, materiale ilustruese (foto, video), CD, rregullore, etj.
-

4. Moduli “Shoqëria e nxënësve”

Kualifikimi profesional: “Shërbime kujdesi për fëmijë”

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

Hartuar në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, “Për zbatimin e moduleve lëndorë Junior Achievement of Albania”.

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SHOQËRIA E NXËNËSVE	M-17-2199-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të krijuar një shoqëri/ kompani biznesi, për të: kryer procedurat e zgjedhjeve për drejtues e personel, analizuar produktin, kryer proceset e shitjes dhe blerjes, për të promovuar produktin e shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjen e raportit përfundimtar.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar klasën e 11 ^{të} , niveli II i KSHK, në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi krijon shoqëri/ kompani. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të kryejë studimin fillestar të tregut për krijimin e një shoqërie/kompanie; - të përcaktojë qartë qëllimin e veprimtarisë së shoqërisë/ kompanisë; - të përcaktojë qartë llojin e biznesit (tregti, prodhim, shërbim, etj.), si dhe fushën ekonomike në të cilën do të zhvillohet veprimtaria; - të vendosë emrin e shoqërisë/kompanisë, duke pasur parasysh veprimtarinë dhe qëllimin e saj; - të përcaktojë qartë misionin dhe vizionin në lidhje me veprimtarinë dhe identitetin e shoqërisë/ kompanisë; - të përzgjedhë formën juridike më të përshtatshme, në varësi të mundësive të financimit dhe kërkesave të pronarëve; - të hartojë dokumentet themelore juridik (statuti/rregullore ose akt themelimi); - të regjistrojë shoqërinë/kompaninë në Qendrën Kombëtare të Bizneseve (QKB). Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi kryen procedurat e zgjedhjeve për drejtues dhe personel.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të planifikojë një proces zgjedhor/rekrutimi transparent (kandidatët, mënyrën e votimit, afatet, rregullat, etj.);
- të ndjekë një rend dhe strukturë të caktuar në organizimin e votimeve (në asamblenë e aksionerëve);
- të hartojë një rregullore të qartë dhe të thjeshtë për funksionimin e departamenteve të shoqërisë/kompanisë;
- të prezantojë rregullat për zgjedhjen në departamente;
- të prezantojë rolet që duhet të mbulojnë kandidatët e propozuar, sipas departamenteve;
- të respektojë mendimin e shumicës dhe kur ai nuk përputhet me preferencat personale;
- të zgjedhë personin e duhur për drejtues/personel, sipas aftësive për rolin;
- të vlerësojë cilësitë e liderit (motivimin, përgjegjshmërinë, korrektësinë, përkushtimin, etj.);
- të përdorë mënyra të ndryshme ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- të kontribuojë për një atmosferë bashkëpunuese, gjatë procesit zgjedhor;
- të pranojë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për drejtues dhe personel.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi analizon produktin e përzgjedhur objekt i veprimtarisë së shoqërisë/kompanisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë qëllimin kryesor dhe dytësorë të studimit të tregut;
- të përcaktojë objektivat e studimit të tregut;
- të përcaktojë metodën bazë për studimin e tregut;
- të krijojë grupin e punës për studimin e tregut dhe të ndajë detyrat në grup;
- të përzgjedhë metodat kryesore dhe burimet e mbledhjes së të dhënave (intervista, pyetësorë, hulumtim online, etj.);
- të përgatitë pyetësorët për mbledhjen e të dhënave të tregut;
- të realizojë me kujdes dhe saktësi intervistimet në funksion të objektit të studimit të tregut;
- të kryejë përpunimin paraprak të të dhënave, duke i seleksionuar ato;
- të kryejë përpunimin statistikor dhe analizën përmbajtësore të të dhënave;
- të përgatisë rezultatet e studimit të tregut (gjetjet dhe propozimet);
- të hartojë planin e biznesit duke:

- prezantuar qartë idenë dhe përshkruar në mënyrë të detajuar sipërmarrjen;
- përshkruar qartë prodhimin/tregtimin;
- përcaktuar karakteristikat që dallojnë ofertën e shoqërisë/kompanisë së tij nga ajo e konkurrentëve;
- përcaktuar vendndodhjen, ku do të zhvillojë aktivitetin biznesi i saj;
- përcaktuar politikat që ndiqen për produktin apo shërbimin;
- pasqyruar tabelat për shpenzimet e parashikuara dhe të ardhurat e pritshme;
- përcaktuar burimet financiare që nevojiten për të kryer investimet fillestare;
- përshkruar se si do të organizohet biznesi, duke specifikuar numrin e të punësuarve, llojin e kontratave dhe kostot relative;
- të kontrollojë përfundimisht strukturën dhe korrektësinë e përmbajtjes së planit të biznesit;
- të vlerësojë cilësinë, dobishmërinë dhe përputhjen e produktit me nevojat e tregut;
- të vlerësojë përfitimet dhe kufizimet e produktit;
- të vlerësojë mendimet e përdoruesve/testuesve të produkteve;
- të përmirësojë vazhdimisht produktin, sipas analizimeve të bëra.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen proceset e blerjes/shitjes.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë nevojat për blerje për fillimin e aktivitetit;
- të evidentojë furnitorët potencialë në fushën e biznesit;
- të analizojë furnitorët ekzistues;
- të kontaktojë furnitorët potencialë dhe të sigurojë informacione për ta;
- të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal, gjatë komunikimit me furnitorët;
- të kërkojë oferta e lista çmimesh për artikuj;
- të krahasojë ofertat e furnitorëve potencialë dhe të evidentojë ofertën më të përshtatshme për biznesin;
- të hartojë planin e blerjes dhe të ndjekë realizimin e tij;
- të ndjekë hapat e duhura, gjatë procesit të blerjes;
- të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm që përdoret, gjatë procesit të blerjes;
- të kërkojë me kujdes informacione për klientët potencialë;
- të përpunojë kërkesat e klientëve;
- të hartojë listat e çmimeve për klientët;
- të hartojë oferta të ndryshme;
- të pranojë, kontrollojë dhe regjistrojë saktë, porositë e mbërritura nga klientët;

- të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm, gjatë procesit të shitjes;
- të kryejë kontrollin e gjendjes fizike të produkteve për shitje;
- të përgatisë produktin për shpërndarje;
- të ambalazhojë produktin, sipas rastit;
- të përzgjedhë kushtet e lëvrimit dhe pagesës që i përshtaten më mirë shoqërisë/kompanisë, qëllimeve dhe kushteve të veprimtarisë së saj;
- të hartojë saktë faturat e shitjes së mallrave;
- të hartojë refuzimet e shitjeve për arsye dhe në situata të ndryshme;
- të zgjidhë situatat në raste ankesash nga klientët;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë blerjes/shitjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kryen promovimin e produktit të shoqërisë/kompanisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë produktin të cilit do t'i bëhet marketingu;
- të identifikojë lloje të ndryshme të platformave digjitale dhe mediave sociale;
- të analizojë kriteret për përzgjedhjen e platformës digjitale dhe medias sociale;
- të përzgjedhë platformën digjitale dhe median sociale;
- të prezantojë platformën digjitale dhe median sociale të përzgjedhur;
- të përgatisë materiale të ndryshme interaktive (tekst, imazh, video, etj.);
- të hartojë fletëpalosje dhe materiale të tjera reklamuese dhe informuese;
- të hartojë kartëvizita e materiale të tjera informative për shoqërinë/kompaninë dhe personelin e saj;
- të ndërtojë video, duke përdorur programe (softëare) të ndryshme (Movie maker ose nëpërmjet aparatit celular, smartphone etj.);
- të modifikojë imazhe të ndryshme me softëare (photoshop, canva, etj.);
- të ngarkojë (publikojë) materialet e mësipërme në platformën digjitale dhe median sociale të përzgjedhur;
- të përgatisë një plan orar, ditor dhe javor në lidhje me promovimin e produkteve të shoqërisë/kompanisë;
- të krijojë fushata marketingu, duke përdorur burime të ndryshme reklamimi (rrjete sociale, e-mail ose mobile marketing);
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm, gjatë promovimit të produktit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi harton dhe analizon raportin vjetor.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë një pasqyrë të thjeshtë financiare të mjeteve, detyrimeve dhe kapitalit të vetë shoqërisë/kompanisë;
- të evidentojë saktë se cilët dokumente do të përdoren për regjistrimin dhe pasqyrimin e veprimtarisë;
- të hartojë saktë dokumentet që mund të përdoren në shoqëri/kompani (ditarin, librin e arkës, librin e magazinës, etj.);
- të regjistrojë gjendjen në dokumentet financiare përkatës;
- të regjistrojë saktë derdhjet e aksionerëve në para dhe në natyrë, sipas llojeve;
- të regjistrojë saktë derdhjet e kapitalit të nënshkruar në fillim dhe gjatë veprimtarisë së shoqërisë/kompanisë;
- të regjistrojë saktë shumat e shpenzimeve të paguara paraprakisht për krijimin, regjistrimin, asistencën ligjore, si dhe për zgjerimin e veprimtarisë ose ndryshimin e formës juridike;
- të regjistrojë blerjet dhe shitjet e kryera;
- të regjistrojë saktë shpenzimet e punës, detyrimet ndaj personelit, sigurimeve dhe shtetit për TAP, duke u bazuar në listëpagesën e pagave;
- të deklarojë në afatin e duhur detyrimet ndaj shtetit;
- të kryejë saktë mbylljen e llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve;
- të evidentojë rezultatin ekonomik të shoqërisë/kompanisë;
- të prezantojë rezultatin përfundimtar të shoqërisë/kompanisë;
- të marrë vendim për shpërndarjen e dividendit, bazuar në përqindjen të aksioneve;
- të kryejë veprimet për likuidimin përfundimtar të shoqërisë/kompanisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në shkollë/klasë dhe në biznes.
- Mësimdhënësi duhet të kryejë demonstrime konkrete lidhur me hapat që ndiqen për: krijimin e një shoqërie/kompanie biznesi, zbatimin e procedurave të zgjedhjeve për drejtues e personel, analizimin e produktit, realizimin e proceseve të shitjes dhe blerjes, promovimin e produktit të shoqërisë/kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjen e raportit përfundimtar.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë lidhur me krijimin e një shoqërie/kompanie biznesi, zbatimin e procedurave të zgjedhjeve

	për drejtues e personel, analizimin e produktit, realizimin e proceseve të shitjes dhe të blerjes, promovimin e produktit të shoqërisë/kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjes së raportit përfundimtar. - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet t'i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për krijimin e një shoqërie/kompanie biznesi, zbatimin e procedurave të zgjedhjeve për drejtues e personel, analizimin e produktit, realizimin e proceseve të shitjes dhe të blerjes, promovimin e produktit të shoqërisë/kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjes së raportit përfundimtar. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënës.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Udhëzuesi i mësuesit. - Udhëzuesi i nxënësit. - Model statuti dhe akt themelimi. - Modele pasqyrash financiare. - Model letra me vlerë/aksione. - Libër i arkës. - Libër/kartela magazine. - Model pyetësori. - Formularë të porosive të shitjeve. - Formularë raportimi. - Materiale kancelarie. - Certifikatat e arritjeve. - Kompjuter/Laptop. - Projektor. - Internet. - USB dhe CD.

XI. Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, Niveli III i KSHK

Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë” Niveli III i KSHK, përmban temat dhe kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim profesional, të trajtuara në lëndët profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e këtij niveli, të cilat do të shërbejnë si bazë për të konceptuar provimet teorike dhe praktike përkatëse.

Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar;
- programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar.

A) Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të Integruar

Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar, në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë”, Niveli III është hartuar duke u mbështetur në temat më të rëndësishme të programeve të lëndëve profesionale më përfaqësuese dhe më thelbësore, të cilat përbëjnë 30-35% të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve profesionale, që përmban skeletkurrikuli përkatës.

Tabela 1: Lëndët profesionale të përzgjedhura për t'u përfshirë në provimin e teorisë profesionale dhe temat e përzgjedhura në të, janë si më poshtë:

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Pediatria e përgjithshme	47	57%
2	Psikologji pediatrike	36	43%
	TOTALI	83	100%

Temat sipas lëndëve janë:

a) Temat nga lënda “Pediatria e përgjithshme”, kl.12;

Gjithsej 47 orë

Tema 7	Nevojat bazike të fëmijës	7 orë
Tema 8	Përlllogaritja e medikamenteve në moshën pediatrike	6 orë
Tema 9	Çrregullimet e sistemit tretës	6 orë
Tema 10	Sëmundjet e sistemit respirator	5 orë
Tema 11	Sëmundjet e sistemit kardio-vaskular	5 orë
Tema 13	Sëmundjet e gjëndrave endokrine	6 orë
Tema 14	Sëmundjet e aparatit urinar	6 orë
Tema 18	Sëmundjet alergjike	6 orë

b) Temat nga lënda “Psikologji pediatrike”, kl.12;

Gjithsej 36 orë

Tema 1	Zhvillimi i sistemit nervor të fëmijës	5 orë
Tema 2	Zhvillimi motorik dhe perceptiv i fëmijës	5 orë
Tema 6	Nevojat psikologjike të fëmijës dhe mirëqenia emocionale	5 orë

Tema 9	Procesi i të menduarit te fëmija dhe përpunimi i informacionit	5 orë
Tema 10	Problemet psiko-sociale te fëmijët	6 orë
Tema 11	Zgjidhja e problemeve dhe të menduarit kritik te fëmijët	5 orë
Tema 12	Ndikimi i lojës në zhvillimin e fëmijës	5 orë

Udhëzime për përgatitjen e testit të provimit të teorisë profesionale:

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me test me shkrim, i cili zgjat 1.5 (një presje pesë) dhe përgatitet nga Komisioni i Provimit Përfundimtar i kualifikimit profesional të nivelit përkatës. Në hartimin e testit komisioni duhet të mbajë parasysh rregullat, parimet dhe formatet, për ndërtimin e testit.

Testi duhet të përmbajë 30 njësi testi me një total prej 60 pikëve. Nga këto, 20 njësi testi të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (4 alternativa) dhe 10 të tjerat të jenë njësi testi me përgjigje të kufizuara/të mbyllura (me PO/JO; me e Vërtetë/e Gabuar; me plotësim të fjalës që mungon; etj.). Testi duhet të shmang pyetjet e hapura.

Model i shpërndarjes së pikëve për pyetje të niveleve të ndryshme në test.

Niveli I (i ulët)	Niveli II (mesatar)	Niveli III (i lartë)
Aftësia për të rikujtuar/kuptuar/identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të zbatuar/argumentuar/shpjeguar/krahasuar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar dhe për të nxjerrë përfundime...

Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve.

Nr.	Lënda	Peshat e lëndëve në %	Pikët për çdo lëndë	Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë		
				Niveli I 40% e pikëve	Niveli II 40% e pikëve	Niveli III 20% e pikëve
1	Pediatria e përgjithshme	57%	34	14	14	6
2	Psikologji pediatrike	43%	26	10	10	6
	TOTALI	100%	60 pikë	24 pikë	24 pikë	12 pikë

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësive të testit. Për shembull: njësitë e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin gjithmonë 1 (një) pikë përkundërt përgjigjes së paracaktuar të saktë; njësitë me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësitë me përgjigje të kufizuara marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrihen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.

Së fundi, skema e vendosjes së notës kundërt pikëve të fituara përcaktohet nga grupi hartues i testit. Në vijim, jepet një model i skemës së vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 10	4
11 - 15	5
16 - 20	6
21 - 30	7
31 - 40	8
41 - 50	9
51 - 60	10

B) Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të Integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin profesional “**Shërbime kujdesi për fëmijë**”, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban skeletkurrikuli përkatës.

a) **Lista e kompetencave profesionale** për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1.	Të bashkëpunojë me prindin/kujdestarin ligjor për mirëqenien e fëmijës.	Detyra 1: Bashkëpunimi me prindin/kujdestarin ligjor për mirëqenien e fëmijës.	20
2	Të plotësojë nevojat bazike të fëmijës.	Detyra 2: Plotësimi i nevojave bazike të fëmijës.	30
3.	Të përkujdeset për shëndetin e fëmijës.	Detyra 3: Përkujdesja për shëndetin e fëmijës.	30
4.	Të zhvillojë aktivitete edukative, krijuese dhe argëtuese.	Detyra 4: Zhvillimi i aktiviteteve edukative, krijuese dhe argëtuese.	20
Shuma			100

b) **Skema e vlerësimit me nota:**

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve në “**detyra pune**”, në mjediset **të simuluar** në kabinetin e kujdesit social-shëndetësor në shkollë.

Nxënësit do të vlerësohen për të paktën një ose dy prej detyrave të mësipërme, për shkak të kohës të përcaktuar të provimit.

- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 (tri) orë, në përputhje kjo me Udhëzimin “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në arsimin dhe formimin profesional”, në fuqi.
- Në çdo detyrë elementë shumë të rëndësishëm, që duhet të jenë të përfshirë në vlerësim, janë respektimi i rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit, sistemimi dhe pastrimi i vendit e mjeteve të punës pasi nxënësi ka përfunduar detyrën.
- Në vlerësimin e detyrave duhet t’i lihet hapësirë bashkëbisedimit profesional, ku komisioni drejton pyetje të parapërgatitura në pikat kyçe të procesit, por dhe në çdo rast kur e shikon të arsyeshme që duhet të ndërhyjë me pyetje, sepse bashkëbisedimi profesional është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.
- Për çdo detyrë komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet e vlerësimit, duke pasur parasysh programin e zhvilluar në këtë nivel, në të gjitha modulet e detyruara të praktikës profesionale, sipas kompetencave përkatëse të përfshira në skeletkurrikul.
- Për çdo detyrë, komisioni i provimit përfshin në vlerësim dhe disa kompetenca të përgjithshme, të cilat janë të rëndësishme, si: vetëkontrolli, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme, komunikimi, pavarësia, bashkëpunimi në grup, bashkëveprimi, etj.
- Komisioni i provimit për të gjitha detyrat parapërgatit tezat e provimit ku nxënësi/grupi në mënyrë të rastësishme zgjedh njërën prej tyre. Komisioni i provimit duhet të përgatisë paraprakisht instrumentin e vlerësimit me procedurat/hapat/etapat e kryerjes së detyrave. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit.
- Vlerësimi i të gjitha detyrave bëhet me listë kontrolli në bazë të instrumenteve përkatëse të vlerësimit.

Detyra 1. “Bashkëpunimi me prindin/kujdestarin ligjor për mirëqenien e fëmijës” do të realizohet në mjedise të simuluar në kabinetin e kujdesit social-shëndetësor në shkollë.

Nxënësit do të përdorin lojën me role ku dy nxënës instruktohen më parë për të luajtur rolin e prindit/kujdestarit ligjor dhe tjetri rolin e kujdestarit. Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Materiale si: manekinë dhe mjete të tjera për të realizuar simulimin e situatave të mësipërme.

Nxënësit diskutojnë dhe angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer planifikim dhe organizimin e punës në shërbime kujdesi për fëmijë. Mësimdhënësi i praktikës mbikëqyr respektimin e rregullave të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit dhe komunikimin e rregullt, gjatë demonstrimit praktik të detyrës.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për bashkëpunimin sa më të mirë të nxënësit me prindin/kujdestarin ligjor.

Detyra 2. “Plotësimi i nevojave bazike të fëmijës” do të realizohet në mjedise të simuluar në kabinetin e kujdesit social-shëndetësor në shkollë. Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale si: manekinë dhe mjete të tjera për të realizuar simulimin e situatave të mësipërme.

Nxënësit diskutojnë dhe angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer planifikim dhe organizimin e punës në shërbime kujdesi për fëmijë. Mësimdhënësi i praktikës mbikëqyr

respektimin e rregullave të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit dhe komunikimin e rregullt, gjatë demonstrimit praktik të detyrës.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për përkujdesjen në plotësimin e nevojave bazike të fëmijës.

Detyra 3. “Përkujdesja për shëndetin e fëmijës” do të realizohet në mjedise të simuluar në kabinetin e kujdesit social-shëndetësor në shkollë. Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale si: manekinë dhe mjete të tjera për të realizuar simulimin e situatave të mësipërme.

Nxënësit do të përdorin lojën me role, ku një nxënës instruktohet më parë për të luajtur rolin e fëmijës së sëmurë dhe nxënësi tjetër realizon përkujdesjen te një fëmijë i sëmurë.

Nxënësit diskutojnë dhe angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer planifikimim dhe organizimin e punë në shërbime kujdesi për fëmijë. Mësimdhënësi i praktikës mbikëqyr respektimin e rregullave të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit dhe komunikimin e rregullt, gjatë demonstrimit praktik të detyrës.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për përkujdesjen te një fëmijë i sëmurë.

Detyra 4. “Zhvillimi i aktiviteteve edukative, krijuese dhe argëtuese” do të realizohet në mjedise të simuluar në kabinetin e kujdesit social-shëndetësor në shkollë. Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.

Nxënësit diskutojnë dhe angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer planifikimim dhe organizimin e **aktiviteteve edukative, krijuese dhe argëtuese për fëmijët**. Mësimdhënësi i praktikës mbikëqyr respektimin e rregullave të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit, si dhe komunikimin e rregullt, gjatë demonstrimit praktik të detyrës. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për përkujdesjen, gjatë zhvillimit të aktiviteteve edukative, krijuese dhe argëtuese.